



MESAZHI I MYFTIUT
ME RASTIN
E FITËR BAJRAMIT 1439



BETEJA E BEDRIT
DHE MËSIMET E SAJ



"300 HADITHE",
LIBËR ME VLERË NË SHËRBIM
TË TRADITËS PROFETIKE

Viti XVI - Nr. 6 (184),
Qershor, 2018

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Fitër Bajrami, simbol bashkimi për muslimanët e Shkodrës



Hatmeja Sherife,

tradita e bukur
e Ramazanit
në Shkodër





Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Ishte viti 1991. Në Shkodër sapo kishte nisur puna për rimëkëmbjen e aktivitetit të Thirrjes Islame. Myftinia Shkodër ishte në hapat e saj të parë. Natyrshëm, vetë qendra e Bashkësisë Islame Shqiptare ishte në Shkodër, ndonëse çdo ditë e më shumë tërhiqej drejt kryeqytetit zyrtar, për t'u transferuar një ditë drejt tij, ndonëse Shkodra dhe aktivistët e saj kishin peshën dhe gjallërinë e krejt Shqipërisë.

Kurset fetare zhvilloheshin te shtëpia e Bajevë, aty ku kishte selinë e vet Myftinia Shkodër. Kujtoj me respekt mësuesit e parë të angazhuar në këtë lëvizje të hershme të rimëkëmbjes; z. Faik Hoxha, z. Faik Zaganjori, z. Nazim Bërdica, që përpiqeshin me aq sa kishin mundësi dhe me aq sa u kishte mbetur nga bagazhi i së shkuarës. Ndërkohë, një shërbim të madh e të pakrahasueshëm jepte Hafiz Mani (H. Sulejman Kraja), shok dersi me Hafiz Sabri Koçin. Përtej përgatitjes dhe formimit që kishte, puna dhe shërbimet e tij u lidhën me xhaminë e vjetër të Kirasit. Mbeti njeri i respektuar, dëshmitar i gjallë i trashëgimisë së hoxhallarëve të tij, në krye të cilëve qëndronte H. Muhamed Bekteshi.

Një gjë ishte garante dhe ndjehej kudo: sinjeriteti dhe shpirti i sakrificës, që në kësi rastesh mbulojnë shumë mangësi e nevoja, mbeten zbuluar deri në ditët e sotme...

HATMEJA SHERIFE, TRADITA E BUKUR E RAMAZANIT NË SHKODËR

Ndër aktivitetet e para, që nisi aty, te salla e shtruar me rrogoza, ku kryheshin faljet e namazeve, ishte edhe Hatmeja e Kur'anit, që më pas u transferua tek salla e faljes në Parrucë. (Rrogizat mblidheshin në fund të ditës dhe mbarteshin me fanatizëm drejt shtëpisë së muezinit Sheuki Rroji, që ritualin e transportimit të tyre e kishte thuar shtëpitë. Shpesh e ndihmonim për t'i mbajtur drejt shtëpisë së tij, në afërsi të Myftinisë. Nuk e kam kuptuar se pse bëhej ky "ritual" i përditshëm, ose është një detaj i megjullt, që s'ka marrë kurrë vëmendjen e duhur në hatrin tim.)

Personazhi më i spikatur i mexhlisit të Hatmes, ishte padyshim Haxhi Nuh

**Hatmeja Sherife
ngeli një traditë e vyer
në mesin e muslimanëve,
traditë që lidhet
me Muajin Ramazan,
por mbi të gjitha
me respektin dhe
përkushtimin ndaj
vetë Kur'anit, Librit që
ngelet Pishtar udhëzimi
deri në kiamet.**

S. Gavoçi! Ai ishte nismëtari i saj dhe personi që mbarte peshën kryesore, me leximin e rrjedhshëm e të ëmbël të Kur'anit. Kishte një vijë melodike të mrekullueshme. Pavarësisht se ai vinte nga shkolla e jetës, tabani familjar kishte bërë të vetën në formimin e tij dhe, falë përkushtimit të të atit, Hafiz Sulejman Gavoçit, ai e kishte mësuar përmendësh Kur'anin prej kohësh. E

lexonte bukur e shtruar, sa dallimet në lexime ndërmjet tij dhe të tjerëve ishin si nata me ditën...

Ai, bashkë me Myftiun dhe disa të tjerë përreth tyre, kishin ndërmarrë një iniciativë të madhe, që nisi me Ramazan dhe vazhdoi si një traditë e mrekullueshme deri në ditët tona.

Dje, në përmbyllje të Hatmes së sivjetshme, aty në xhaminë e Parrucës, mbushur me besimtarë dhe besimtare, më dukej se ajo frymë e ai shpirt sakrifikues i para 27 viteve të shkuara, ishin përzier me dëshirën e sotme të baballarëve e nënave, djemve të rinj dhe pjesëmarrësve besnikë, që për 27 ditët e këtij Ramazan, si çdo Ramazan, ndoqën me shumë përkushtim leximet e komentimet e sureve dhe 30 xhyzeve të këtij Kur'an, me të cilin u bekua jeta e jonë që 15 shekuj më parë, kur nisi të shpallej për herë të parë!

Dje, teksa luteshim bashkërisht, ndjehej kudo mirësia e dhe bekimet, që rrethojnë mexhlistet e Hatmes, në përfundim të së cilës ka një lutje të pranuar, siç thoshte Imam Bukhari i madh, e siç vepron shumë kohë para tij sahabët e më të Mirit të gjithësisë... Nga ajo kohë e papërsëritshme, Hatmeja Sherife ngeli një traditë e vyer në mesin e muslimanëve, traditë që lidhet me Muajin Ramazan, por mbi të gjitha me respektin dhe përkushtimin ndaj vetë Kur'anit, Librit që ngelet Pishtar udhëzimi deri në kiamet.

Rahmet paçin të shkuarit, sinjeriteti dhe përkushtimi i tyre, vullneti dhe dëshira e madhe për ta ruajtur traditën dhe gjurmët e të parëve në kërkim të pëlqimit të All-llahut, nëpërmjet mexhliseve dhe tubimeve, me të cilat Ai mburret para melekëve të Tij..!

Shkodër, 11 qershor 2018

MESAZHI I MYFTIUT TË SHKODRËS ME RASTIN E FITËR BAJRAMIT 1439

Të nderuar dhe të dashur vëllezër dhe motra besimtarë muslimanë,

Tashmë që Hana e re e Muajit Shevval, po bëhet gati të shfaqet mbi horizontet e botës sonë, më lejoni t'ju uroj me rastin e fillimit të Festës së Fitër Bajramit 1439.

Për 30 ditë, të gjithë u bekuam me agjërim dhe lutje, me adhurime dhe bamirësi, që na morën për dore drejt lartësimit në shkallët më të larta të përkushtimit në jetë. Pikërisht, ky përkushtim, ishte dhe mbeti thelbi kryesor i Muajit Ramazan.

Për këtë, më lejoni t'ju ftoj në leximin dhe reflektimin e drejtë të ajeteve të sures Ali Imran, që dua të jenë edhe mesazhi kryesor i kësaj Feste: "Dhe shpejtoni (me punët që meritoni) në falje gjynahesh nga Zoti juaj dhe drejt një xheneti, gjerësia e të cilit është si gjerësia e qiejve dhe e tokës, i përgatitur për të përkushtuarit. Të cilët japin kur janë mirëqenie edhe kur janë në vështirësi dhe që e frenojnë mllëfin, që ua falin (të keqen) njerëzve; All-llahu i do bamirësit! Edhe ata të cilët kur bëjnë ndonjë (gjynah) të shëmtuar ose i bëjnë padrejtësi vetvetes, e përmendin All-llahun dhe kërkojnë falje për gjynahet e tyre. E kush i falë gjynahet përveç All-llahut? Dhe, që duke e ditur, nuk vazhdojnë në atë që kanë punuar (në të keqen). Shpërblimi i të tillëve është falja nga Zoti i tyre dhe xhenetet nëpër të cilët rrjedhin lumenj, e aty do të rrinë përgjithmonë. Sa i mirë është shpërblimi i atyre që punojnë!"¹

1. Kur'ani, Ali Imran: 133-136.

Ju ftoj me zemër të ndahemi nga realitetet e vulgut, që na tërheqin drejt idhujtarisë, shirkut dhe formave të devijuara të besimit, drejt intrigave dhe tendencave përçarëse që e shkatërrojnë harmoninë kombëtare, ku njeriut i kërkohet të shpëputet nga mendja dhe logjika, të zhvishet nga shpirti dhe morali, nga identiteti dhe thirrja reale e shpirtit të tij, ku padrejtësia dhe manipulimi tentojnë të qëndrojnë në fronet e drejtimit të jetës dhe shoqërisë!

Kurrësesi nuk duhet të pranojmë që besimi ynë të nëpërkëmbet, që pastërtia dhe drejtësia e Islamit tonë të kthehet në objekt diskutimi në mesin e të devijuara, që punojnë me kazmat e injorancës dhe racizmit për të shkatërruar vlerat e lirisë, besimit dhe harmonisë njerëzore në mesin e racës së përzgjedhur nga Zoti i gjithësisë për mbartjen e amanetit më të shtrenjtë të gjithësisë; Përhapjes së Fjalës së Tij!

Tashmë, që agjërimi ynë po nis drejt vendit të Dëshmive të mëdha, lutem me zemër që All-llahu i Madhëruar ta begatojë e ta udhëzojë drejt Dashnisë së Tij popullin tonë, ta forcojë Islamin në zemrat tona dhe të na bëjë të ndjehemi krenarë më këtë fé shekullore dhe të lashtë, sa lashtësia e njeriut mbi tokë!

Gëzuar Fitër Bajramin!

Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Shkodër, më 30 Ramazan 1439 / 14
qershor 2018



PEJGAMBERI (A.S) KA THËNË:

"Kush e kalon

në adhurim

Ramazanin,

me besim

dhe bindje,

i falen të gjitha

gjynahet

e kaluara."

(Buhariu dhe Muslimi)



Naim Driaj,
imam, xhamia Parrucë

Lufta e Bedrit ka ndodhur me shtatëmbëdhjetë Ramazan në vitin e dytë të hixhretit ditën e xhuma. ¹ Kjo është lufta e parë që është zhvilluar mes muslimanëve dhe politeistëve të Mekës. Shkaku i kësaj lufte ishte goditja e karvanit, që e udhëhiqte Ebu Sufjani dhe marrja e pasurisë që politeistët ua kishin konfiskuar muslimanëve kur ata emigruan për në Medinë.

Lufta e Bedrit nxori në pah vlerën e besimit, identitetit dhe qëndrueshmërisë. Në këtë luftë janë përballur vëllai më vëllanë, babai me djalin e tij etj.

1. AJO QË KA KAKTUAR ALLAHU DHE NDDODH ME LEJEN E TIJ ËSHTË MË E MIRA MË E DOBISHMJA

Nga kjo betejë kuptohet qartë ajeti kuranor, ku Allahu (xh.sh) thotë: “Mund ta urreni një gjë, ndërkohë që ajo është e mirë për ju dhe mund ta doni një gjë, ndërkohë që ajo është e dëmshme për ju. Allahu di, kurse ju nuk dini”. ² Profeti (a.s) me sahabët e tij dolën në këtë ekspeditë për karvanin e jo për të

1. Ibn Hisham, Sire, II/286, Ahmed ibn Hanbel, Musned, IV/54, Ibn Ebi Shejbe, Megazi, 174, Belazuri, Ensab, III/124.

2. El-Bekare, 216.

BETEJA E BEDRIT DHE MËSIMET E SAJ

luftuar. Allahu iu premtoi fitoren mbi njërën prej dy grupeve, që ai të ishte i juaji. ³ (ose karvanin ose luftën).

2. LIDHJA E FUQISHME ME ZEMËR MES BESIMTARËVE

Muslimanët në këtë luftë numerikisht ishin pak dhe kishin një përgatitje modeste në raport me kundërshtarin. Allahu (xh.sh) thotë: “Ai është që përkrahu me ndihmën e Tij dhe me besimtarët, duke i bashkuar zemrat e tyre (si një zemër e vetme). Sikur të shpenzojnë tërë pasurinë që gjendet në Tokë, nuk do të mund t’i bashkoje zemrat e tyre, por Allahu i bashkoi ato”. ⁴ Besimtarët ishin të lidhur me zemër më njëri-tjetrin ndërsa politeistët ishin të lidhur për interesa të caktuara.

3. KONSULTIMI

Profeti (a.s) kur mori vesh se karvani kishte ikur dhe një ushtri nga meka (nën komandën e Ebu Xhehlit) po vinte në drejtim të Medinës nuk mori vendim vetë për të dalë në betejë, por u këshillua me shokët e tij. Allahu (xh.sh) thotë: “Këshillohu me ata për çështje të ndryshme”. ⁵ Ata që kishin dalë me Profetin (a.s) ishin mekasit dhe banoret e Medines së bashku. Marrëveshja që nënshkroi Profeti (a.s) me banorët e Medines në Akabe ishte që ta mbronin brenda Medines dhe jo jashtë saj. Kurse Profeti (a.s) tani ndodhej jashtë Medines. Duke pasur parasysh këtë, Pejgamberi (a.s) u foli sahabëve dhe u tha: “Thoni mendimin tuaj, o njerëz!” Çohet Ebu Bekri (r.a) dhe i thotë: “Bëj atë që shikon të arsyeshme, o i Dërguar i Allahut!” Profeti (a.s) i thotë: “Zoti

të shpërbleftë me të mira”. Më pas u drejtua përsëri njerëzve dhe u tha:

“Thoni mendimin tuaj, o njerëz!” Çohet Omeri (r.a) dhe i thotë: “Bëj atë që shikon të arsyeshme, o i Dërguar i Allahut, se ne jemi me ty!” Profeti (a.s) i thotë: “Zoti ta shpërbleftë me të mira o Omer”. Më pas u drejtua përsëri njerëzve dhe u tha: “Thoni mendimin tuaj, o njerëz!” Çohet Mikdad ibn Amri (r.a) dhe i thotë: “O i Dërguar i Allahut, bëj atë që të thotë Zoti se ne jemi me Ty. Për Zotin nuk do të të themi ashtu siç i thanë çifutët Musait: “Shko ti me Zotin tënd dhe luftoni se ne do të qëndrojmë këtu” ⁶ por të themi: “Shko ti me Zotin tënd të luftoni, se edhe ne do të luftojmë me ty. Betohem në Atë që të dërgoi me të vërtetën, ne do të të ndjekim në çdo hap që do të ecësh”. ⁷

Këto fjalë e gëzuan Profetin (a.s) sepse të gjithë ato që folën deri tani ishin muslimanët e Mekes (muhaxhirët). Profeti (a.s) kërkonte dhe miratimin e muslimanëve të Medines. Për këtë ai i pyeti sërish: “Thoni mendimin tuaj, o njerëz!” Atëherë çohet Sad ibn Muadhi (r.a), i pari i fisit Eus dhe i thotë: “Sikur kërkon mendimin tonë, o i Dërguar i Allahut?” “Po”, iu përgjigj Profeti (a.s). Atëherë Sad ibn Muadhi i thotë: “Ne të kemi besuar dhe kemi dëshmuar që mesazhi me të cilin je dërguar është i vërtetë. Për këtë ne të premtuam bindje, respekt dhe të dhamë besën. Prandaj vepro si të duash! Betohemi në Atë që të ka dërguar me të vërtetën, nëse do të hyje në det, do të hynim pas teje, pa munguar asnjëri nga ne.” ⁸ Merr nga

6. Kur’ani, El-Maide, 24.

7. Nessârî, Mahmud, Câmiu’r-Rivâyât fî Tahkîki Nübüvvâti’n-Nebî, f. 39, Beyrut, 2004.

8. Ibn Sad, Tabakat, III/535.

"Ne të kemi besuar dhe kemi dëshmuar që mesazhi me të cilin je dërguar është i vërtetë. Për këtë ne të premtuam bindje, respekt dhe të dhamë besën. Prandaj vepro si të duash! Betohemi në Atë që të ka dërguar me të vërtetën, nëse do të hyje në det, do të hynim pas teje, pa munguar asnjëri nga ne".

pasuritë tona çfarë të duash dhe lër çfarë të duash. Ajo që do të marrësh nga pasuritë tona do të jetë më e dashur për ne se ajo që le. Hyr në paqe me këtë duash dhe shpalli armiqësi kujt të duash, mbaj lidhjet me këtë duash dhe ndërpriti me këtë duash. Për Zotin ne nuk kemi frikë nga takimi me armikun nesër. Ne jemi durimtarë në luftë dhe të sinqertë në betejë. Shpresojmë që Zoti të të tregojë gjëra me të cilat do të gëzohesh”. ⁹

Këto fjalë e gëzuan shumë Profetin (a.s), i cili u tha më pas: “Përgëzohuni, pasi Zoti më ka premtuar njërën nga dy të mirat (o fitoren, o karvanin). Për Zotin, më duket sikur i shoh (kurejshitët) të vvarë.”

4. DASHURIA E MADHE E SAHABËVE PËR PEJGAMBERIN (A.S) I BËRI ATA QË TË LUFTOJNË

Nuk ishte e lehtë për Muhaxhirët që sapo erdhën në Medinë të dalin në luftë po ashtu as i Ensarëve që sakrifkuan çdo gjë për vëllezërit e tyre të ardhur nga Meka, por dashuria e madhe që kishin ndaj Profetit (a.s) i bëri ata që të dalin e të luftojnë. Nëse ne e duam Pejgamberin (a.s) edhe neve na do Zoti (xh.sh), e nëse neve na do Zoti (xh.sh) atëherë çfarë mund të duam tjetër?

5. REALITETI I FITORES NUK ËSHTË VETËM AI FIZIK POR AI PARIMOR

Muslimanët në Bedër fituan edhe fizikisht por ajo që është e rëndësishme është se fitoi besimi, e drejta dhe e vërteta. Allahu i Madhëruar në librin e Tij e emërtoi këtë betejë si dita e “Furkanit” ¹⁰ (dita e ndarjes së të vërtetës nga e pa vërteta).

6. KTHIMI TEK ALLAHU (XH.SH) ME DUA PASI I KEMI MARRË TË GJITHA MASAT E DUHURA

Pejgamberi (a.s) pasi i kishte marrë të gjitha masat e duhura ju lut Allahut (xh.sh) : “O Zot, realizojë premtimin

9. Ibn Hisham, Sire, II/272.

10. Kur’ani, El-Enfal, 41.

Tënd. O Zot, nëse sot do të vritet ky grup besimtarësh nuk do të ketë kush të të adhurojë më në tokë”. Vazhdoi të lutet me duart lart, saqë i ra dhe xhybeja të cilin e kishte hedhur krahëve. Shkoi Ebu Bekri (r.a) dhe ia hodhi përsëri krahëve dhe i tha: “O Profet i Zotit, të mjaftojnë këto lutje drejtuar Zotit. Të jesh i sigurtë që Ai do e mbajë premtimin që të ka bërë”. ¹¹

Më pas Profeti (a.s) ngriti kokën nga qielli dhe tha: “Po zbret Xhibrili me një mijë melekë për t’u dhënë ndihmë besimtarëve”. ¹²

(Dikush mund të pyes përse zbriten melekët e tjerë, a nuk do mjaftonte xhibrili (a.s) ? Sigurisht që po. Por natyrshmëria e luftës ishte prania e komandantit dhe ushtrisë, kjo i përngjante ushtrisë që udhëhiqte vetë Profeti (a.s)). Allahu (xh.sh) thotë: “Ju kërkuat ndihmë nga Zoti juaj e Ai ju përgjigj: “Unë do t’ju ndihmoj me një mijë melekë të cilët do të vijnë njëri pas tjetrit”. ¹³ Besimi dhe bindja që Zoti do na ndihmojë duhet të shoqërohet gjithmonë me përpjekje dhe planifikimin tonë.

7. FALËNDERIMI I ZOTIT (XH.SH)

Çdo sukses që njeriu arrin në jetën e tij ia ka borxh Zotit prandaj duhet që ta falënderojmë shumë Atë. Allahu (xh.sh) thotë: “Fitorja vjen vetëm nga Allahu”. ¹⁴

8. VLERA E DITURISË

Në këtë betejë bëhet e qartë vlerë e diturisë në fenë Islame. Shembull për këtë është kushtëzimi që Pejgamberi (a.s) bëri. Për lirin e robërve të varfër të cilët dinin shkrim- lexim, Profeti (a.s) kushtëzoi që secili nga ata t’u mësojë dhjetë fëmijë të muslimanëve shkrim-lexim. Ndërsa të pasurit i shpagoi sipas pasurisë që posedonin.

11. Muslimi, Sahih, Kitâbu’l-Cihâd, ve’s-Siyer, 18.

12. Ibn Hishâm, Sire, II/286-287.

13. Kur’ani, El-Enfal, 9.

14. Kur’ani, El-Enfal, 10.



I Dërguari i All-llahut (a.s) ka thënë:

“Ruajuni

nga ekstremizmi

në fé, sepse

shumë nga

popujt para jush

u shkatërruan

nga ekstremizmi

në fé!”

"300 Hadithe"



Lavdrim Hamja,
imam, xhamia e "Dy Vajzave"

Çdo përpjekje, sakrificë dhe punë që bëhet për kumtimin dhe përcjelljen e Traditës Profetike tek njerëzit dhe tek brezat e ardhshme konsiderohet punë e lavdërueshme dhe madje zbatim i fjalës së vetë Profetit (a.s.), i cili ka thënë: “Kumtoni nga unë, qoftë edhe një ajet (fjalë)”.

Kjo për vetë faktin, se në Kur'anin Famëlartë ne jemi të urdhëruar të ndjekim shembullin e tij (a.s) dhe gjithashtu të marrim atë që na ka urdhëruar dhe të largohemi prej asaj që na ka ndaluar. Kështu na urdhëron Zoti i Madhëruar në Kur'an, ku thotë: “Atë që jua ka dhënë i Dërguari, merreni dhe atë që ju ka ndaluar prej saj, largohuni”. – (Kur'ani, El-Hashr: 7)

Këtij urdhri kuranor dhe kësaj porosit profetike i është përgjigjur edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, i cili vjen me librin e tij më të ri: “300 Hadithe”. Ky libër me vlerë dhe shumë i çmuar për myslimanët shqiptar përmban 300 hadithe nga Tradita Profetike, të përzgjedhura me kujdes prej autorit në mesin e 10.031 haditheve të veprës së madhe të Imam Sujutit: “El-Xhamius-Sagir”, siç e sqaron edhe vetë autori në parathënien e librit.

Për veprën e autorit në shqip kam qenë në dijeni përpara se të botohet, por kur këtë vepër e mora të botuar në dorë, mu kujtua hadithi i Pejgamberit (a.s), të transmetuar në të Dy Librat e Saktë dhe që e transmeton Ebu Musa (r.a), se Pejgamberi (a.s) ka thënë:

“Shembulli i udhëzimit dhe i diturisë me të cilin Allahu më ka dërguar, është sikur shembulli i shiut që bie në tokë. Prej saj ka pjesë toke që e pranon ujin dhe mbin shumë bimë e kullosë, prej saj ka pjesë që e mban ujin dhe me atë ujë Allahu i bën njerëzit të përfitojnë prej saj duke pirë, duke vaditur dhe

“300 HADITHE”, LIBËR ME VLERË NË SHËRBIM TË TRADITËS PROFETIKE

ujitur dhe prej saj ka pjesë toke, që nuk mbledh ujë e as nuk mbin asgjë. Ky është shembulli i atij që e kupton fenë e Allahut, përfiton prej asaj që Allahu më ka dërguar, i bën dobi të tjerëve, mësoi për vete dhe i mësoi të tjerët dhe shembulli i atij që nuk përfiton asgjë dhe nuk e pranon udhëzimin e Allahut, me të cilin jam dërguar.”

Në koment të këtij hadithi, Dr. Jusuf El-Karadavi thotë: “Hadithi simbolizon, atë që Shpallja ka sjellë prej udhëzimit dhe diturisë të krahasuar me shiun në përgjithësi, që ngjall token e vdekur, ashtu siç ngjallin shkencat e fesë zemrat e vdekura. Gjithashtu simbolizon tipat e njerëzve në aftësitë e tyre për të përvetësuar këtë dituri me llojet e ndryshme të tokës”.

Kështu që, dobia e kësaj vepre me 300 Hadithe në gjuhën shqipe, konsiston në faktin se përveç përkthimit korrekt dhe me shije të haditheve të Pejgamberit (a.s), autori i shoqëron ato me komente të vlefshme, që ia shtojnë edhe më tepër vlerën dhe dobinë këtij botimi.

Se sa e rëndësishme dhe me dobi është kjo vepër në gjuhën shqipe rreth Traditës Profetike e tregon vetë autori, ku në parathënien e librit sjellë fjalën e autorit në arabisht, i cili thotë: “Kam lexuar me vëmendje edhe parathënien e veprës së Imam Sujutit, ku ndër të tjera shkruan: “Falënderimi i takon All-llahut, i Cili dërgoi në krye të çdo njëqind viteve, dikë që t'i reformojë këtij ymeti, çështjet e fesë së tij... Në këtë libër kam vendosur me mijëra nga fjalët e të Dërguarit, shumë prej urtësive të të Përzgjedhurit, duke u mjaftuar me hadithet e shkurtra... E quajta: “El-Xhamius-Sagir” – “Përmbledhësi i vogël”, sepse ai është nxjerrë nga libri i madh, që e kam quajtur: “Xhem'ul-Xhevami” – “Përmbledhësi i përmbledhësve”...”, - përfundon citimi. Kështu që me të drejtë ne mund të themi se kjo përmbledhje në gjuhën shqipe është “Përmbledhësi i përmbledhës së vogël nga përmbledhja e madh”, pra kemi ajkën e urtësisë së Pejgamberit (a.s) të zgjedhur në mesin e 10.031 hadithe të të Dërguarit të Allahut (a.s), që edhe këto qindra hadithe janë

përzgjedhur në mesin e mijëra të tjerë, prej thesarit të urtësisë profetike, i cili u dërgua “Mëshirë për mbarë botët”.

Vepra që kemi në dorë është e ndarë dhe e grupuar me hadithe sipas tematikave të ndryshme, e që i japin larmi librit dhe e bëjnë atë shumë të lehtë për t'u lexuar dhe për t'u mësuar. Gjithashtu, edhe faqosja e bukur e librit dhe me finesë krijojnë një përshtypje me Zotërinë e këtyre haditheve, Hz. Muhammedin (a.s).

Autori në shqip ndjek edhe amanetin shkencor të dijes, ku i qëndron strikt përcaktimit të burimit nga ku është marrë hadithi, për të qenë korrekt me përcjelljen e fjalës së Pejgamberit (a.s) dhe për t'i dhënë siguri lexuesit se këto



hadithe janë marrë nga burimet e tyre origjinale dhe njëkohësisht, i japin mundësinë njerëzve të dije, nëse u nevojitet, ta kenë të lehtë verifikimin me tekstin origjinal në gjuhën arabe.

Për këtë, në parathënien e botimit shqip, Imam Sytari thotë: “I kam ndarë në grupe me nga dhjetë hadithe, ku kam shënuar origjinën e tyre në veprën e Imam Sujutit, duke shënuar edhe numrin e hadithit dhe atë të faqes; ndoshta dikujt do t'i duhet për të bërë krahasime e për të kërkuar tekstin origjinal. ... Për efekt të korrektesisë shkencore, bri secilit hadith kam vendosur edhe gradën e tij, siç ka bërë autori, Imam Sujuti dhe siç e ka korrigjuar ndonjëherë edhe komentuesi i tyre, Imam Mennavi”.

Nëse fillojmë dhe shfletojmë këtë botim kaq me vlerë në përmbajtje, por

edhe në paraqitje, do të na përfshijë fryma e fjalëve të urta, të bukura dhe me plot kuptim e domethënie e të Dërguarit të Allahut (a.s), të cilat padyshim janë mesazhe drite dhe parime universale, që tregojnë madhësinë e Islamit dhe vlefshmërinë e tij për të gjitha kohërat dhe botët, por edhe gradën e lartë të të Dërguarit të fundit dhe urtësinë hyjnore, që Zoti i gjithësisë i dha këtij Pejgamberi, për të qenë dritë udhëzuese për mbarë njerëzimin deri në ditën e fundit të kësaj bote.

P.sh. në faqen 3, në hyrje autori ka vendosur dy thënie profetike shumë universale: “Përhapeni selamin, të paqtoheni!” dhe “Përhapeni selamin në mes jush, të duheni!”. Sigurisht, që Islami është paqe, por ndoshta për të na treguar se ajo që do të vijojë pas kësaj hyrjeje është e gjitha paqe dhe zbatimi i atyre fjalëve-porosi sjell paqe mes njerëzve, vëllezër të njëri-tjetrit.

Megjithatë, Imam Sytari në hyrje të kapitullit të parë “Më të mirët ndër ju” e shpjegon qëllimin e realizimit të kësaj vepre, ku thotë: “Qëllimi i kësaj përzgjedhjeje, është të vë në dukje faktin se, nëpërmjet pjesës më të madhe të këtyre haditheve, Resulull-llahu (a.s.) ka promovuar dhe nxitur mirësinë dhe virtytet e larta në shoqëritë islame dhe ato njerëzore në përgjithësi, duke na dhënë të kuptojmë se, Islami nuk është thjeshtë falja e namazeve ditore, agjërimi a haxhi, zekati a shehadeti; ato janë shtyllat kryesore të tij, boshti kryesor i fesë tek ne! Porse, hapësirat e praktikimit të kësaj feje janë pa fund dhe e tejkalojnë cakun e pesë shtyllave kryesore. Ato përfshijnë çdo detaj dhe çdo fushë të jetës, duke u përhapur kudo si balsam shërues për realitetet e larmishme dhe situatat, nëpër të cilat kalon njeriu në jetën e tij!” – faqe 13.

Porosi profetike të tilla si:

“Më të mirët ndër ju janë më të edukuarit ndër ju!” - (Hadithi nr. 3984, f. 243. Ahmedi, Bukhariau dhe Muslimi, Tirmidhiu, nga Ibn Amri),

“Më i miri i shoqërisë tek All-llahu është më i miri i tyre për shokun e tij. Më i miri i komshive tek All-llahu është më i miri i tyre për komshiun e tij!” - (Hadithi nr. 3998, f. 244. Ahmedi, Tirmidhiu dhe Hakimi, nga Ibn Amri).

“E mëshiroftë All-llahu një prind që e ndihmon fëmijën e tij drejt respektit të tij!” - (Hadithi nr. 4442, f. 272. Ebush-Shejkh, nga Aliu).

Me të vërtetë këto janë porosi të

arta, për të cilat shoqëria njerëzore ka nevojë t'i prejë dhe t'i shijojë në jetën e përditshme dhe në marrëdhëniet mes njerëzve. Sa shumë kemi nevojë për njerëz të edukuar, komshinj të mirë dhe prindër shembullorë, të cilët pjesën më të madhe të kohës së tyre ua kushtojnë fëmijëve dhe jo lojërave të ndryshme shkatërruese e veseve të këqija, që po prishin familjet dhe po humbin fëmijët.

Siç e përmenda edhe më lart, në këtë vepër është përzgjedhur ajka e thesarit të të Dërguarit të fundit në zinxhirin e të gjithë Profetëve të Zotit të dërguar më parë, që nga Ademi (a.s) e deri te Isai, i biri i Merjemes (a.s). Duke ju lënë të gjithëve, në pritje të shfletimit të plotë të veprës po e mbylli me citimin e një hadithi tjetër të Pejgamberit (a.s), ku thotë: “Krejt ju jeni përgjegjës dhe secili prej jush do të pyetet për atë që ka në përgjegjësinë e tij! Prijësi është përgjegjës dhe do të pyetet për përgjegjësinë e tij! Burri është përgjegjës në familjen e tij dhe do të pyetet për përgjegjësinë e tij! Gruaja është përgjegjëse në shtëpinë e burrit të saj dhe do të pyetet për përgjegjësinë e saj!

Shërbëtori është përgjegjës në pasurinë e zotërisë së tij dhe do të pyetet për përgjegjësinë e tij! Njeriu është përgjegjës për pasurinë e babait të tij dhe do të pyetet për përgjegjësinë e tij! Krejt ju jeni përgjegjës dhe secili prej jush do të pyetet për atë që ka në përgjegjësinë e tij!” - (Hadithi nr. 6370, f. 396. Ahmedi, Bukhariau, Muslimi, Ebu Davudi dhe Tirmidhiu, nga Ibn Omeri).

Nuk ka dyshim, se kjo fjalë profetike sensibilizon secilin njeri dhe secilin prej nesh, për rëndësinë dhe barrën e rëndë që ka pozita e tij në këtë jetë, prind, bashkëshort, bashkëshorte, punëtor i thjeshtë, pronar, nëpunës, drejtues, udhëheqës e kushdo qoftë ai. Ky hadith bën të ditur se patjetër një ditë secili njeri, do të japë llogari për përgjegjësitë e tij dhe i gjithë përfundimi i tij varet nga mënyra se si i ka kryer dhe realizuar këto përgjegjësi. Zoti na u bëftë ndihmë të gjithëve dhe na udhëzoftë drejt më së mirës.

Në mbyllje, lutem që Allahu i Madhëruar ia pranoftë autorit këtë vepër në shërbim të Traditës së Pejgamberit (a.s) dhe i dhashtë mbarësi e sukses në punën e tij.

Faleminderit!

(Fjala e mbajtur në promovimin e librit “300 Hadithe”, më 21 maj, 2018)



I Dërguari i All-llahut (a.s) ka thënë:

“E mëshiroftë

All-llahu

një person

që dëgjon

një fjalë prej nesh,

e kupton atë,

pastaj ia përcjell

dikujt që mund

të jetë

më i thellë

në kuptim!”

(Transmetuar nga Ibn Asakir)

Pasditën e së shtunës, më 12 maj 2018, në sheshin e xhamisë së Parrucës, Myftinia Shkodër organizoi aktivitetin tradicional: “Sofra e Kur’anit”, me hafizë të ardhur nga Turqia dhe Maqedonia.

Të nderuarit H. Adnan Kadria (MK), H. Avni Hasani (MK), H. Sejid Temur (TR) dhe H. Idriz Arasoglu (TR), prezantuan para të pranishmëve pjesë të ndryshme nga Kur’ani, duke ndezur zemrat me emocione që përjetohej në tubimet e begata ku lexohet Fjala e Zotit të gjithësisë.

Aktivitetin e përshëndeti Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili tha se ky tubim i ngjan dallëndysheve të pranverës që lajmërojnë stinën e shumëpritur të freskisë, gjallërimit të jetës dhe rrezeve plot begati të diellit.

Myftiu falënderoi hafizët e nderuar, që për të dhjetin vit radhazi organizojnë këtë karvan të begatë të këndimit të Kur’anit Famëllartë në trojet e Ballkanit, duke përhapur rreze drite kur’anore dhe

“SOFRA E KUR’ANIT”, SI BEKIM DHE PREHJE SHPIRTËRORE MBI SHKODËR



duke mbushur zemrat me bekim e paqe.

Për rreth një orë, të pranishmit patën mundësi të ndjekin këndimet e bukura, që u mbyllën me këndimin e ezanit

drejtpërsëdrejti nga sheshi i xhamisë së Parrucës.

Sofra e Kur’anit është kthyer në një traditë qytetare në prag të çdo Ramzani.

MYFTIU: “TË ANGAZHUEMI PËR NJË MUAJ TË MBARË PLOT HARMONI!”

Paraditën e së hënës, më 14 maj 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari zhvilloi një takim këshillimor me imamët kryesorë të qytetit, me të cilët diskutoi mbarëvajtjen e aktivitetit fetar dhe shërbimeve në xhami përgjatë Muajit Ramazan 1439.

Myftiu tha se është e domosdoshme që

të ruhet harmonia dhe fryma e vëllazërisë nëpërmjet angazhimeve të shumta që kanë imamët me xhematin, sidomos në namazin e faljen e 20 rekateve të namazit të teravisë, respektimit të kalendarit zyrtar të orareve të adhurimeve ditore, lutjet, mexhlisi i Hatmes Sherife, etj.

U diskutua edhe mundësia e

qarkullimit në xhami të ndryshme, sipas një grafiku që i shërben larmisë së jetës fetare në xhamitë e qytetit dhe fshatit gjatë këtij Muaji.

Myftiu falënderoi imamët për sakrificat e tyre dhe u lut për mbarësinë e secilit në shërbimet plot përkushtim gjatë Muajit Ramazan 1439.

NAMAZI I TERAISË GJALLËRON XHAMITË E SHKODRËS



Prej specifikave të Muajit të Begatë të Ramazanit është edhe namazi i teravisë. Ky namaz falet vetëm gjatë netëve të Ramazanit, menjëherë pas namazit të jacisë. Namazi i teravisë është prej syneteve të forta e të vërtetuara që në jetë të Hz. Muhammedit (a.s). Namazi i teravisë falet me xhemat, ka 20 rekate, të cilat ndahen me pesë selame, pas katër rekatesh, që falen si syneti i iqindisë dhe ai i jacisë.

Namazi i teravisë ka një vlerë të madhe, pasi e ndihmon besimtarin në rrugëtimet e tij për të fituar kënaqësinë e All-llahut të Madhëruar nëpërmjet faljes së namazeve.

Me hyrjen e hënës së re të Muajit Ramazan 1439, në të gjitha xhamitë e Shkodrës, më 15 maj 2018, nisi edhe falja e teravisë së parë të këtij Muaji.

Nga xhamia e Parrucës, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, uroi besimtarët me rastin e fillimit të Ramazanit të këtij viti, duke u lutur për begati dhe mirësi, si dhe për paqe e

mëshirë mbi krejt botët.

Myftiu tha se ky Muaj na fton drejt përmirësimit të marrëdhënies me Zotin dhe mësimet e Tij, drejt vetëllogaritjes, për të parë secili se ku është në raport me besimin dhe praktikën e tij në jetën

e përditshme. Njëkohësisht, ftoi të pranishmit që të shfrytëzojnë kohën për të bërë më të mirën në përvetësimin e kësaj mundësie të madhe, që i jepet besimtarëve një herë në vit, përgjatë krejt këtij Muaji të Begatë.

Pasdrekën e së enjtes, më 17 maj 2018, një grup besimtarësh u nisën për në vendet e shenjta, për kryerjen e Umres në ditët e para të Ramazanit të sivjetshëm.

Natyrisht, Umreja në ditët e Muajit Ramazan ka një vlerë të madhe dhe një shpërblim të veçantë nga All-llahu, për krejt sakrifkuesit që e ndërmarrin këtë udhëtim për kryerjen e adhurimeve të agjërit, Umres, namazeve, etj., në këtë kohë të begatë në më të mirin vend të botës.

Në përcjellje të besimtarëve dhe familjeve të tyre, ishte edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari me një grup imamësh.

Në fjalën e tij, Myftiu porositi grupin e besimtarëve që ta shfrytëzojnë maksimalisht kohën për të kryer adhurimet dhe lutjet e këtyre ditëve të begata, për të dhënë sadeka e për të mos harruar për asnjë moment privilegjin e

NJË GRUP BESIMTARËSH NGA SHKODRA U NISËN PËR UMREN E RAMAZANIT 1439



madh që i ka bërë All-llahu i Madhëruar, duke i ftuar në Shtëpinë e Tij, në më të mirin e muajve dhe në një periudhë ku të gjithë kërkojnë mëshirën dhe faljen e Tij.

Myftiu uroi që vëllezërit dhe motrat

që nisen sot për të kryer Umren, të kenë një udhëtim të rehatshëm, të shkojnë dhe të kthehen shëndosh e mirë dhe të luten për të gjithë, me shpresën e pranimit nga Zoti Mëshirëbërës!

MYFTIU: “MOS LEJONI QË PLUHURI TË MBULOJË KAPAKËT E KUR’ANIT!”

Nga xhamia e “Dy Vajzave”, të xhumanë e parë të Ramazanit të sivjetshëm, më 18 maj 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari foli mbi rëndësinë e shfrytëzimit të Muajit Ramazan për t’u afruar me All-llahun Fuqiplotë nëpërmjet Fjalës së Tij, Kur’anit.

Myftiu tha se angazhimi për leximin dhe kuptimin e Kur’anit është vepra më e pëlqyer tek All-llahu, sikurse porositi i Dërguari i Tij. Ai vetë ishte reflektuesi më i mirë i tij, saqë Nëna e jonë Aishe e

përshkruante me këto fjalë: “Moral i tij ishte Kur’ani!”.

Ai tha se përderisa ky Libër ka mburojë të përhershme hyjnore, ymeti islam duhet të ecë përpara me kurajo dhe dinjitet, duke respektuar thirrjen e Zotit dhe duke iu bindur Atij, pa pasur asnjë mëdyshje në asnjë prej ajeteve dhe konteksteve të tyre!

Njëkohësisht tha se, kohëve të fundit kemi dëgjuar për përpjekje të dështuara që vijnë nga perëndimi për të cinguar Kur’anin dhe për ta djegur atë. Përtej

këtij primitivizmi, Myftiu tha se secili duhet të shohë në vetvete se çfarë vendi zë Kur’ani në jetën e tij dhe sa e vlerëson ai Fjalën e All-llahut.

“Kapakët e Kur’anit nuk duhet të na i prekë pluhuri! Nëse kjo ndodh, do të thotë se ne të parët nuk kemi respekt për Fjalën e Zotit!”, tha ndër të tjera Myftiu.

Ai bëri edhe një lutje, ku përmendi edhe plagët e ymetit, sidomos Palestinën martire dhe u lut për një rimëkëmbje të fortë të mbarë ymetit islam.

Mbrëmjen e së dielës, më 20 maj 2018, në xhaminë e “Dy Vajzave”, u organizua iftari i parë me xhematin dhe një grup imamësh të nderuar të Shkodrës.

Ky iftar vjen në kuadër të bashkëpunimit të Myftinisë Shkodër me Institutin Shqiptar të Mendimit dhe Qytetërimit Islam, që ndërmjetësoi për ndërtimin e kompleksit fetar në vakëfin e Shaban efendisë.

Pas faljes së namazit të akshamit me xhematë, sofrën e iftarit e përshëndeti imami i xhamisë së “Dy Vajzave”, teologu Lavdrim Hamja, i cili shprehu kënaqësinë e tij me rastin e këtij tubimi vëllazëror.

Ndërkohë Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, falënderoi AIITC-në për këtë mirësi të madhe. Ai shprehu mirënjohjen dhe falënderimet e tij edhe për drejtorin e Institutit, Dr. Ramiz Zekaj,

SOFRA BUJARE E IFTARIT NË XHAMINË E “DY VAJZAVE”



sikurse u lut për mbarësi dhe adhurime të pranura.

Në fjalën e tij përshëndetëse, teologu Alban Kodra, vuri theksin te fryma e vëllazërisë dhe e bashkëpunimit në

Muajin Ramazan. Njëkohësisht shprehu urimet e tij për krejt agjëruarit, me lutjen që Zoti i Plotfuqishëm të pranojë veprat e mira dhe sakrificat e këtij Muaji të begatë.

Festivali i leximit “Ditënetët e Librit”, i organizuar me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës vijon veprimtaritë e tij në Tiranë, në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar. Në ditën e tij të katërt stenda e AIITC e pranishme në këtë panair, zhvilloi promovimin e librit më të fundit të botuar nga AIITC, i titulluar “300 hadithe”, të autorit Muhamed Sytari, Myfti i zonës së Shkodrës.

Në ceremoninë e zhvilluar në sallën “Shpataraku” të MHK, morën pjesë teologë, pedagogë, studentë dhe dashamirës të librit. Takimin e hapi nëndrejtori i AIITC, Alban Kodra i cili i falënderoi të pranishmit në emër të Drejtorit të AIITC Prof. As. Dr. Ramiz Zekaj për pjesëmarrjen e tyre. Si fillim ai prezantoi një përmbledhje të historisë së hadithit tek shqiptarët, me autorët më të njohur dhe veprat e tyre në këtë lëmi e deri në ditët e sotme. Ndër ta ai përmendi mevludet, librat e dijetarëve Ibrahim Dalliu, Abdullah Zëmlaku, Vehbi Ismaili etj., si dhe botimet moderne të veprave origjinale si “Sahih el-Buhari”, “Sunen Ebu Davud”, “Muhtesar Sahih el-Buhari”, “40 hadithet e imam Neveviut” dhe të tjera botime.

Më pas ai përshkroi shkurtimisht vijat e përgjithshme të librit “300 hadithe”, duke e cilëzuar atë një vepër antologjike me perla profetike të nxjerra prej detit të paanë të urtësisë muhamedane. Më hollësisht për këtë libër foli teologu Lavdrim Hamja. Ai zbërtheu mesazhet kryesore që ka dashur të përcjellë autori përmes saj, përshkroi metodologjinë e

AIITC PROMOVON ANTOLOGJINË E THËNIEVE PROFETIKE “300 HADITHE”



ndjekur në përzgjedhjen dhe përkthimin e lëndës hadithore dhe vlerësoi elegancën e dizajnit që synon ta afrojë lexuesin me përshpirtshmërinë që përcjellin fjalët profetike.

Ndërsa autori i veprës, imam Muhamed Sytari u foli të pranishmëve për përvojën e tij me hadithin e Profetit Muhamed (a.s). I nisur nga dëshira për t'i sjellë lexuesit një libër që të përfaqësojë më së miri udhëzimin dhe shëmbëlltyrën profetike, ai përzgjodhi nga vepra madhore “El-Xhami es-saghir” me 10 mijë hadithe, 300 të tilla. Ai u shpreh se është munduar të hartojë një libër që të jetë i vlefshëm për t'u lexuar jo vetëm nga besimtarët muslimanë, por edhe nga jomuslimanët, sepse Profeti (a.s.) u dërgua si mëshirë për të gjithë njerëzit. Për të ilustruar qëndrimet e tij, ai u lexoi të pranishmëve

dhjetë hadithe nga krerë të ndryshëm të librit, duke komentuar shkurtimisht kuptimin dhe mesazhet e tyre.

Në përfundim, Kryetari i Bordit të AIITC vlerësoi lart librin, duke e quajtur udhëzues që të çon në destinacionin e duhur. Po ashtu, ai e cilësoi leximin e tij të domosdoshëm nga ana e të gjithëve, veçanërisht për problemet që po kalon shoqëria bashkëkohore. Pas vlerësimeve të rastit nga të pranishmit, ceremonia u mbyll me urimet më të mira për autorin që pena e tij të sjellë bukur në gjuhën tonë perla të tjera nga fjalët dhe mësimet e Profetit të Mëshirës. Ndërkohë pjesëmarrësit u interesuan pranë stendës së AIITC, ku blenë me ulje këtë botim të vyer, në muajin e bekuar të Ramazanit.

(www.aiitc.net)

Pasditën e së mërkurës, më 23 maj 2018, besimtarë të shumtë kishin ardhur për të marrë pjesë në faljen e xhenazes së plakut të mirë e të urtë, H. Xhelal Sokoli, i cili u nda dje nga jeta e kësaj bote.

Ai ishte një ndër nismëtarët e rihapjes së Xhamisë së Plumbit, më 16 nëntor 1990, si dhe një ndër themeluesit e Bashkësisë Islame Shqiptare, që u ndryshua më vonë duke u zvogëluar e ndryshuar në thelb, në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë.

Në fjalën e rastit, njëri ndër bashkëpunëtorët e tij, H. Fejzi Zaganjori, me shumë emocion mbajti një fjalë të madhe, duke vlerësuar kontributin e H. Xhelal Sokolit dhe bashkëpunëtorëve të tij, si shembull sakrificë dhe besimi në All-llahun e Madhëruar dhe rimëkëmbjen e fesë së Tij në vendin tonë.

Njëkohësisht, shprehu dhembjen e tij për mosshkrimin e historisë së vërtetë të sakrificës së këtyre burrave të urtë dhe

QOFSH I XHENNETIT H. XHELAL SOKOLI!



largpamës, që lanë gjurmë të heshtura.

Xhenazen e drejtoi Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili u lut për rahmetliun dhe ngushëlloi të afërmit dhe besimtarët për ndarjen nga jeta e

përkohshme e të nderuarit H. Xhelal Sokoli.

All-llahu e mëshiroftë dhe e pranoftë në mesin e të përkushtuarve në rrugën e Tij!

Ditën e hënë, më 21 maj 2018, Myftinia Shkodër organizoi ceremoninë e promovimit të botimit më të ri nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, me titull: “300 HADITHE”.

Ceremonia që u zhvillua në ambientet e Medresës së vajzave, nisi me fjalën e rastit nga teologu Arben Halluni, i cili bëri një prezantim të shkurtër të këtij botimi të ri.

Ndërkohë, një analizë të shkoqitur trajtoi teologu Lavdrim Hamja. Në fjalën e tij, ai u ndal te rëndësia që ka ky botim për shtimin e njohurive të mëtejshme në raport me fjalën e të Dërguarit (a.s.) dhe mesazhet e urta që ato përmbajnë.

Referoi edhe shkrimtari Xhahid Bushati, i cili ndër të tjera theksoi: “Libri më i ri i titulluar “300 Hadithe”, përkthyer nga arabishtja, përshtatur në shqip dhe pajisur me shënime dhe komente nga Imam Muhamed B. Sytari, për kohën e ardhjes së botimit, mban dritën dhe aromën e ditëve dhe netëve të Ramazanit. Natyrisht kjo dritë dhe kjo aromë do të na shoqërojë gjatë, germë pas germe, fjalë pas fjale, shprehje pas shprehjeje, fletë pas flete teksa do ta shfletojmë me kujdes... Është detyrë e jona, e përhershme, jo vetëm të trokasim në dyert e dijes së vërtetë, por ta përvetësojmë atë e ta vendosim pranë zemrës dhe shpirtit, duke e pyetur atë herë pas here në ecjen e udhëve të jetës...

Puna e lavdërueshme dhe serioze e përkthyesit Sytari për t'i sjellë këto vlera që shoqëria dhe koha jonë i kërkon domosdoshmërisht, na bën të mendojë

Mbrëmjen e së hënës, më 21 maj 2018, gjatë ceremonisë së promovimit të librit më të ri nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, “300 HADITHE”, një fjalë përshëndetëse mbajti edhe znj. Greta Bardeli, Kryetare e Këshillit të Qarkut Shkodër.

Gjatë fjalës së saj, znj. Bardeli vlerësoi punën e Myftiut dhe misionin e tij, sidomos në drejtim të përhapjes së vlerave të harmonisë ndërfaqetare dhe përkrahjen e shtresave me vështirësi të ndryshme.

Me këtë rast, ajo lajmëroi se, në mbledhjen e datës 19 maj 2018, Këshilli i Qarkut Shkodër vendosi t'i akordojë titullin: “NDERI I QARKUT SHKODËR”, Imam Muhamed Sytarit, me motivacionin: “Si veprimtar i shquar për forcimin e mëtejshëm të harmonisë dhe bashkëjetesës ndërfaqetare në Qarkun Shkodër. Për mbështetjen shpirtërore dhe

U PROMOVUA LIBRI “300 HADITHE”



se dimensiononi i Hadithit nuk njih moshë, nuk njih mplakje. Ai është koherent dhe dritësijellës. Gjithashtu, përkthyesi me prijesinë e tij teologjike dhe me aftësinë profesionale të përkthimit, na bën të mendojë, se germa, fjala, letra nuk harrohet, nuk zvetënohet, nuk pluhuroset. Dituria e vërtetë, morali i vërtetë, shërbesat e vërteta i kalojnë shekujt e kontinentet, udhëtojnë e udhëtojnë... siç po udhëton e do të udhëtojë ky libër...”

Ceremonia vijoi me fjalën e autorit, që ndër të tjera tha: “Bota e sotme përpëlitet në vorbulla të çuditshme, herë-herë të frikshme e në raste të tjera thuajse imponuese drejt një fryme zhgënjyese, rrethuar nga diktati prej të forti arrogant, dhunës dhe urrejtjes, racizmit dhe frikësimit të njerëzimit me termat e luftës dhe shkatërrimit, që janë

përpapur gjithandej, si tentakulat e një oktapodi të egërsuar vrasar. Gjithandej flitet për vlerat qytetëruese, për moralin dhe familjen, për besimin dhe sigurinë, për ekonominë e forta dhe mirëqenien, për zhvillimin teknologjik dhe arritjet shkencore. Kjo është diçka e vlefshme dhe tepër inkurajuese për brezat e ri dhe të ardhmen e botës sonë.”

Më pas foli për shkakun që e ka nxitur drejt kësaj pune dhe u lut për mbarësi e bekime, për Shkodrën, Shqipërinë dhe mbarë botën.

Për të ftuarit u shtrua edhe iftari i kësaj dite, falë mbështetjes së Shoqatës “Istanbul” dhe Kryetarit të saj, z. Ridvan Seferaj.

Autori dhuroi librin e ri për të pranishmit, bashkë me dedikimet e rastit.

“NDERI I QARKUT SHKODËR” PËR MYFTIUN IMAM MUHAMED SYTARI



përkrahjen e njerëzve dhe në veçanti të atyre që përballen me vështirësi.”

Pas marrjes në dorëzim të këtij titulli të lartë, Myftiu tha se ky vlerësim është përgjegjësi, por mbi të gjitha, ai i përket angazhimit të imamëve, prijesve fetarë të Shkodrës dhe besimtarëve, që dinë të ruajnë vlerat e besimit dhe në veçanti frymën e harmonisë në mesin e besimeve.

Ai tha se kjo vlerë është një amanet shekullor, që duhet ta ruajmë e ta kultivojmë tek breznitë e ardhshme, si një mirësi e paqes dhe bashkëjetesës në vendin tonë.

Të pranishëm në këtë mbrëmje ishin autoritetet më të larta të Shkodrës, si: Kryetarja e Bashkisë Shkodër, Prefekti i Qarkut Shkodër, Kryetarja e Këshillit të Qarkut Shkodër, Kryetari i Këshillit të Bashkisë Shkodër, Kryetari i Gjykatës, Kryetari i Gjykatës së Apelit, Myftiu i Malësisë së Madhe, përfaqësues të Kishës Katolike dhe asaj Ortodokse, drejtues të shoqatave, antarët e Këshillit të Myftinisë Shkodër, imamë, teologë, drejtues të Medresës “Haxhi Sheh Shamia”, intelektualë dhe familjarë të autorit.

Në një bashkëbisedim të zhvilluar mbrëmjen e së martës, më 22 maj 2018, në Star Plus Tv, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari foli për vlerat e Muajit Ramazan, si periudhë e ngjeshur adhuresh dhe thirrjeje për ta dëshmuar shpirtin e besimit në jetë.

Myftiu iu përgjigj pyetjeve të gazetarit Erzen Koperaj, duke nxjerrë në pah mirësitë e shumta që ka agjërimi në vetvete, si adhuring, si dhe dobietë që i vijnë shoqërisë, pjestarët e së cilës angazhohen me vlerësimin e respektimin e Muajit Ramazan.

“Një shoqëri e agjërit nuk është shoqëri droge, alkooli, krimi e korrupsioni, prandaj qeveritë dhe institucionet duhet të ndajnë buxhete të caktuara për ta gjallëruar atmosferën e Ramazanit dhe për ta përhapur sa më shumë frymën e tij të paqte, aq më shumë në një vend me shumicë muslimane si Shqipëria!”, tha Myftiu.

MYFTIU: “AGJËRIMI ËSHTË SHPRESË PËR SHOQËRINË!”

Gjithashtu, ai tha se po të kemi një sondazh të saktë të përqindjes së agjëruësve në rang kombëtar, sa më e madhe të jetë kjo përqindje, aq më shpresë e bekime ka për shoqërinë.

Dhe vijoi: “Agjërimi e bën individin të fortë, mbartës të përgjegjësisë, ndërtues të jetës, përballues të sfidave me një shpirt të pathyeshëm besimi! Agjërimi është shpresë për shoqërinë, për kombin, për të sotmen dhe të ardhmen e njerëzimit!”.

Myftiu ftoi besimtarët që ta ndajnë atmosferën e begatë të Ramazanit me krejt shoqërinë, sepse sikurse tha: “Ramazani është Muaji i Kur’anit, që thërret: “O ju njerëz!”, prandaj mos ta mbyllim atmosferën e tij vetëm për vete; të ftojme të afërm e komshi, bashkëqytetarë e familjarë në sofrat e



iftarit, jo për të ngrënë e për t’u mburrur me menutë e tij, por për të hapur zemrat e për të shpërndarë mirësi e paqe, nga shpirti i këtij besimi e kësaj feje që është shpallur si mëshirë e paqe për gjithësinë!”.

MYFTIU: “SALAVATI, HALLKA QË NA MBAN TË LIDHUR ME DASHNINË E HZ. MUHAMMEDIT (A.S.)!”

Mbrëmjen e së enjtes, më 24 maj 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari e fali teravinë e kësaj nate me besimtarët e xhamisë së Medresës dhe me nxënësit e kursit të Kur’anit.

Gjatë një këshille fetare të mbajtur para namazit të jacisë, Myftiu foli për vlerën që ka respektimi i natës së xhuma, si moment për të shtuar salavatit për të Dërguarin e All-llahut.

Myftiu tha se salavati është hallka që na mban të lidhur me dashninë e HZ. Muhammedit (a.s.) dhe njëkohësisht pragu që na bën të meditojmë e të



kuptojmë madhësitë e qenies pjesë e ymetit të tij (a.s.).

“Sonte është natë e xhuma, natë salavati. Pse ka rëndësi ta shtojmë salavatit? Ka vlerë të madhe për të kontrolluar zemrën se në çfarë marrëdhënieje është me dashninë e HZ. Muhammedit (a.s.), i cili na deshti para se të vinim në këtë botë, si dhe për ta falënderuar All-llahun e Madhëruar që na bëri pjesë të ymetit të tij (a.s.). Është si të thuash, hallka që na mban të lidhur me shpirtin e madh të besimit dhe shpresa e afimit të përhershëm me zotërinë e bijve të Ademit, për dashninë e të cilit jemi urdhëruar në Kur’an!”, tha ndër të tjera Myftiu.

MYFTIU: “MOS TË NA KALJË RAMAZANI VETËM SI NDRYSHIM RREGULLI NË USHQIM!”

Natën e së shtunës, më 26 maj 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari zgjodhi xhaminë e Rusit për të kryer faljen e namazit të teravisë.

Në mesazhin e tij para besimtarëve të pranishëm, Myftiu theksoi se është shumë e rëndësishme që Muaji Ramazan mos të na kalojë thjeshtë si një periudhë kohore, ku ndryshojmë rregullin e ushqimit!

“Ka shumë rëndësi ta pyesim veten, tashmë që kaloi një e treta e Ramazanit të sivjetshëm, nëse ka ndryshuar diçka

brenda vetes sonë, apo jemi njësoj si para fillimit të Ramazanit? Ky Muaj vjen si një mundësi ndryshimi dhe përmirësimi i cilësisë së jetës sonë mbi tokë, duke përmirësuar sjelljen tonë me Zotin, me veten, me familjen, me shoqërinë dhe me vetë jetën!”, tha ndër të tjera Myftiu.

Ai nxiti frenimin nga përgojimi, thashethemet dhe humbja e kohës, sikurse tha se: “Në librat e Hadithit, gjejmë një fjalë shumë të madhe dhe të frikshme njëkohësisht nga i Dërguari i All-llahut (a.s.), i cili i pyeti një ditë sahabët nëse e

dinin se kush është i falimentuari? Pastaj u shpjegoi atyre se i falimentuar në ditën e gjykimit është ai që vjen me namaz, agjërim e adhuringe, por njëkohësisht ka sharë atë e ka fyer këtë, ka goditur njërin e i ka bërë padrejtësi tjetrit. Pastaj do t’i merren sevapet e tij dhe do t’i jepen të lënduarve, sikurse do të merren gjynahet e tyre e do t’i ngarkohen atij, derisa të ndëshkohet!”

Myftiu kërkoi prej besimtarëve që të luten për hallet e vendit tonë, që sot në vitin 2018, nuk meriton të jetë në këtë gjendje, ku ka degraduar!

Ai falënderoi edhe imamin e kësaj xhamie, të nderuarin H. Fejzi Zaganjori, për angazhimet e tij në shërbim të komunitetit.

Paraditën e së dielës, më 27 maj 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzier konsullin e ambasadës së Kuvajtit në vendin tonë, z. Jaser El-Bedr.

Me rastin e kësaj vizite, z. El-Bedr uroi Myftiun për Muajin e agjërit, ku theksoi se Ramazani është mundësia më e mirë për t’u takuar e afuar më shumë, duke dëshmuar vlerat e besimit, solidaritetit dhe humanizmit.

Ai e lajmëroi Myftiun se me rastin e kësaj vizite, ambasada e Shtetit të Kuvajtit, do të dorëzojë një sasi të konsiderueshme me pako ushqimore për njerëz në nevojë, si një traditë e përvitshme e bujarisë kuvajtiane në mbarë botën.

Nga ana e tij, Myftiu e falënderoi konsullin kuvajtian për vizitën dhe shprehur mirënjohjen e tij për kontributet e shumta që Shteti i Kuvajtit ka dhënë për vendin tonë.

Njëkohësisht falënderoi qëndrimet

NDIHMA BUJARE E SHTETIT TË KUVAJTIT NË DITËT E RAMAZANIT 1439



fisnike të Emirit të Kuvajtit në realitetet nëpër të cilat kalon bota arabe dhe ymeti islam, ku theksoi se historia do të regjistrojë këto përpjekje në rrugën e bashkimit të muslimanëve dhe forcimit të këtij uniteti për të mirën e mbarë njerëzimit.

Më pas, u shpërnda një pjesë e

kontingjentit të ndihmave për besimtarë dhe njerëz në nevojë.

Myftinia Shkodër shpreh mirënjohjen dhe falënderimet e saj për Shtetin e Kuvajtit dhe ambasadën e tij në Tiranë, për kontributet e vazhdueshme në shërbim të komunitetit dhe njerëzve në nevojë.

MYFTIU: “T’IA KUJTOJMË VETES SE, NUK JEMI TË PËRJETSHËM KËTU KU JEMI!”

Mbrëmjen e së hënës, më 28 maj 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari vizitoi xhematin e xhamisë së Plumbit, me të cilët fali bashkërisht edhe namazin e teravisë.

Në një këshillë fetare pas namazit, Myftiu foli për vdekjen dhe përkujtimin e shpeshtë të saj. Ai tha se muslimani nuk ka komplekse nga përmendja e vdekjes, përkundrazi, ai e di shumë mirë se ajo

është pjesë e marrëdhënies së natyrshme që njeriu ka me këtë jetë kalimtare.

“Hz. Muhammedi (a.s) na porositi që ta përkujtojmë sa më shpesh vdekjen, që në vetvete na udhëzon vëmendjen tonë drejt një të vërtete të madhe, që s’e mohojmë dot.

Të gjithë do largohemi një ditë nga kjo botë, e cila nuk është krijuar për të qenë e përjetshme. Sa e sa prej të dashurve tanë nuk janë sot me ne, një

ditë edhe ne do largohemi.

Prandaj, është e udhës që në këto ditë e net të adhuringit e lutjes, agjëritit e pendimit, t’ia kujtojmë vetes se, nuk jemi të përhershëm këtu ku jemi; të kemi kujdes kohën, marrëdhëniet me njerëzit, me vetë kohën!”, tha ndër të tjera Myftiu.

Ai e shoqëroi këshillën e tij edhe me ajete kur’anore dhe rrëfime nga koha e të dërguarve të ndryshëm, që mbeten yje udhëzimi deri në kiamet.

PRIZREN, MYFTIU MORI PJESË NË IFTARIN E BASHKËSISË ISLAME



besimit, moralit, dijes dhe vlerave tona shekullore kombëtare!”

Me rastin e kësaj vizite, Myftiu i

dhuroi Kryetarit të KBI të Prizrenit librin e tij të ri “300 HADITHE”, me urimet më të mira me rastin e Muajit Ramazan 1439.

Nga minberi i xhamisë së “Dy Vajzave”, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, foli sot, të xhumanë, më 1 qershor 2018, rreth domosdoshmërisë së qëndrueshmërisë në besim dhe lidhjes përherë e më shumë me fenë duke u distancuar plotësisht nga ndikimi negativ që kanë fushatat e organizuara kundër Islamit dhe vlerave të tij, sot në vendin tonë.

Myftiu tha se, përtej faktit se e xhumaja e sotme mund të përqendrohej tek beteja historike e Bedrit; mësimet dhe mesazhet e saj, porse realitetet e sotme dëshmojnë një distancë shumë të madhe në mes gjendjes së ymetit islam dhe shpirtit të betejave të Resulull-llahut (a.s.).

Myftiu tha se muslimani i sotëm

Paraditën e së shtunës, më 2 qershor 2018 Myftinia Shkodër dhuroi për shoqatën e invalidëve Para & Tetrapelgjikë, dega Shkodër 30 pako ushqimore për njerëzit në nevojë të kësaj shoqate.

Kryetari i shoqatës së invalidëve Para & Tetrapelgjikë, z. Saimir Beqiri falënderoi Myftininë e Shkodrës dhe veçanërisht Myftiun e Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari, i cili iu përgjigj menjëherë thirrjes së tij për të ndihmuar këta njerëz në nevojë. Ai uroi të gjithë besimtarët myslimanë për muajin e begatë

PRESIDENTI I REPUBLIKËS PREZANTOI NË IFTARIN E HARMONISË KOMBËTARE NË SHKODËR



Dita e 20-të e Ramazanit 1439, e hëna e 4 qershorit 2018, mbledhi së bashku në iftarin e harmonisë kombëtare, intelektualë, artistë, drejtues të shoqatave islame, këshilltarë të Myftinisë, drejtues të komuniteteve fetare në Shkodër, myftilerë të ardhur nga Prizreni dhe Ulqini, drejtues të institucioneve lokale të qytetit, si kryetarja e Bashkisë, kryetarja e Këshillit të Qarkut, kryetari i Këshillit të Bashkisë,

MYFTIU: “JEMI SHUMË LARG PËR TË FOLUR PËR BEDRIN!”

shqiptar ka nevojë të fitojë betejën e tij me veten, me familjen e rrethin shoqëror, duke u rrënjësuar zemra e tij në Islam dhe duke e dëshmuar fenë e tij me plot krenari legjitime, kudo e me këdo!

Në hytben e tij, iu referua një këshillë fetare të mbajtur nga sahabiu Abdull-llah ibn Mes'ud (r.a), kur në prani të Resulull-llahut (a.s.) tha: “O ju njerëz, All-llahu i Madhëruar është Zoti ynë, Islami është feja e jonë, Kur'ani është prijësi ynë, Shtëpia (Qabeja) është kibla e jonë dhe ky është profeti ynë - dhe bëri me shenjë nga profeti (a.s.) –! Kemi pëlqyer atë që ka pëlqyer All-llahu i Madhëruar për ne

dhe i dërguari i Tij, sikurse kemi refuzuar atë që ka refuzuar All-llahu i Madhëruar për ne dhe i dërguari i Tij!”.

Myftiu bëri thirrje që shoqëria të mos ndikohet nga propaganda e djallëzuar e disa mediave që thërrasin për të mos agjëruar, sikurse e konsideroi si të papranueshëm faktin që në disa shkolla të vendit, mësuesit nxisin fëmijët për të mos mbajtur agjërimin.

Në fund të hytbes, Myftiu foli edhe për regjistrimet e Haxhit të sivjetshëm dhe lajmëroi besimtarët për mënyrën e udhëzimit rreth kësaj teme.

RAMAZANI, MUAJ I SOLIDARITETIT DHE HARMONISË SOCIALE

të Ramazanit dhe agjërim të pranuar.

Në emër të Myftinisë Shkodër përshëndeti teologu Lavdrim Hamja, imam i xhamisë së “Dy Vajzave”, i cili tha se, është përherë emocion dhe përgjegjësi të ndihmohet njerëz të veçantë, të cilët në fakt e kemi për detyrë t'i ndihmojmë në çdo rast duke dëshmuar frymën e solidaritetit dhe harmonisë në komunitet.

Ai bëri thirrje besimtarëve dhe mbarë

qytetarëve, por sidomos institucioneve të kontribuojnë për këtë kategori njerëzish, të cilët janë amanet dhe e kemi për borxh t'u gjendemi pranë.

Njëkohësisht teologu Hamja përcolli edhe selamet dhe përshëndetjen e veçantë të Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed Sytari për kryetarin e shoqatës së invalidëve Para & Tetrapelgjikë, dega Shkodër dhe për të gjithë të pjesëtarët e kësaj shoqate.

krijesat e Tij. Është Muaj i identitetit të vërtetë të shpirtit dhe zemrës, udhëzues drejt ndërtimit të vlerave dhe pastrimit nga sprovat, që mbushin realitetet e shoqërisë me papastërtitë mbytëse të femohimit, imoralitetit, korrupsionit, gënjeshtërisë, përmbysjes së njësive matëse të së mirës dhe të keqes në jetë, përhapjes së fenomeneve denigruese të shpirtit të lartë kombëtar, që mësynjë plot meskinitet familjen dhe vlerat e saj, që tundojnë rininë drejt drogës e bixhozit, alkoolit e shthurjes, që në vetvete janë të barazvlefshme me rrënimin e trashëgimisë së të parëve dhe dështimin e garantuar në të ardhmen e kombit dhe atdheut.”

Të pranishmit i përshëndeti edhe Presidenti i Republikës, Sh.T.Z. Ilir Meta, i cili uroi besimtarët me rastin e Muajit Ramazan dhe vlerësoi frymën e bashkëpunimit dhe shpirtin e harmonisë komunitare në mesin e besimtarëve dhe qytetarëve në Shkodër.

Në përfundim, lutja e iftarit u bë nga H. Fejzi Zaganjori, i cili u lut për pranimin e agjërimin dhe veprave të mora, si dhe për mirëqenien dhe begatinë e Shqipërisë dhe shqiptarëve.

Ditën e martë, më 5 qershor 2018, Myftinia Shkodër organizoi promovimin e botimit më të ri me titull: “E vërteta e hidhur -2-”, nga dijetari i shquar, Shejkh Muhammed El-Gazali, përkthyer në shqip nga teologu Lavdrim Hamja.

Aktivitetin e hapi teologu Arben Halluni, i cili pasi uroi të pranishmit për prezencën e tyre, bëri një rezymë të shkurtër për librin në fjalë dhe për kontributin e dijetarëve të Ezheri Sherif, ndër të cilët është edhe Shejkh Muhamed El-Gazali.

Në këtë aktivitet ishte i pranishëm edhe kryetari Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Skënder Bruçaj, i cili uroi besimtarët e pranishëm për muajin e begatë të Ramazanit dhe shprehu kënaqësinë e tij për këtë takim të përzemërt me besimtarët e njëkohësisht kënaqësinë e promovimit të një libri.

Më pas e mori fjalën Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, i cili pasi falënderoi përkthyesin Lavdrim Hamja, ndër të tjera tha: “Librin e ri e kam shfletuar kohë më parë, kur po përgatitej për botim. Jemi ulur e kemi diskutuar gjatë për 38 temat e tij, të përzgjedhura nga përkthyesi. Janë tematika të jetës së përditshme, që ngacmojnë ymetin dhe botën mbarë. Tematika që lidhen me ngritjen e nivelit të hytbeve në xhamitë tona, dilemat e nxitura

Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, në vazhdim të iftareve të shtruara me grupe të ndryshme besimtarësh në të gjithë vendin, shtoi një iftar edhe me studentët e përfshirë në programet edukative të AIITC. I ftuar në këtë iftar ishte Myftiu i Zonës së Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, i cili shquhet për aktivitetin e tij botues në lëmin e literaturës fetare, krahas veprimtarisë si drejtues i jetës fetare islame në rrethin e Shkodrës.

Ky aktivitet ishte organizuar në një mënyrë krejt të veçantë, ku studentët patën mundësinë që para ngrënies së iftarit, të dëgjonin prej myftiut të nderuar ligjëratën me temë: “Urtësi dhe këshilla profetike me frymë Ramazani”. Gjatë fjalës së tij, Imam Sytari dha për studentët pjesëmarrës disa këshilla mbi përfitimet shpirtërore e morale nga agjërimi i Ramazanit.

Myftiu Sytari theksoi se Ramazani është muaj i një përkushtimi të jashtëzakonshëm, muaji i rimëkëmbjes shpirtërore dhe i vendosjes së ekuilibrave të shëndoshë në marrëdhënien tonë me Zotin. Sipas tij, sprovat e vërtetë nis me mbarimin e Ramazanit, nëse besimtarët do të munden ta vazhdojnë frymën e tij në jetën e tyre. Ai nënvizoi se ky muaj bazohet në tre shtylla,

U PROMOVUA LIBRI “E VËRTETA E HIDHUR -2-” NGA SHEJKH MUHAMED EL- GAZALI



nga orientalistë rreth ajeteve të Kur'anit dhe Hadithit, humanizmit, edukimit të fëmijëve, mexhliset e dhikrit, kriza e shpirtmadhësisë, etj.

Është frymëzim i madh të lexosh Shejkh Gazaliun, kur thotë: “Nuk konsiderohet kthim në Islam të shkruajmë mbi flamuj: “All-llahu ekber”, por kthim në Islam quhet të mbushim zemrat me “All-llahu ekber” dhe ta bëjmë Atë (All-llahu ekber) motiv të punëve dhe qëllim të jetës sonë!”.

Pastaj, foli edhe përkthyesi i librit, teologu Lavdrim Hamja, ku pasi dha një jetëshkrim të shkurtër rreth autorit, ndër të tjera tha: “Të përkthesh kolosë të mëdhenj

dhe veçanërisht të fushës teologjike, si p.sh shejkh Muhamed El-Gazali nuk është punë e lehtë. Ai kur shkruante ishte letrar i përsosur, Zoti (xh.sh) i kishte dhuruar retorikë dhe qartësi, e cila bënte për vete zemrat e lexuesve, sa që ashtu siç e kanë thënë edhe njerëz të tjerë, sikur shejkh Gazali do t'i ishte kushtuar fushës së letërsisë, ai do të kishte arritur majat e saj”.

Gjithashtu përkthyesi Hamja tha se: “Libri “E Vërteta e Hidhur -2-” i shejkh M.El-Gazalit është vazhdimësi e kolanës së tij me të njëjtin titull, ku në pranverën e vitit 2014, me mbarësinë e Zotit, botova vëllimin e parë. Libri përmban artikuj të dobishëm, që autori i ka shkruar gjatë një periudhe kohore jo shumë të shkurtër. Përmes këtyre shkrimeve Shejkh Gazali i bën një mbrojtje Islamit nga dy grupe njerëzish të ndryshëm, njëri grup janë myslimanët me dije të cekët, të cilët e njollosin Islamin me diçka që ai nuk e ka, ndërsa grupi tjetër janë armiq të Islamit, që përpiqen ta akuzojnë fenë me gjëra, që edhe këto nuk i përkasin dhe as nuk kanë lidhje me Islamit”.

Me rastin e këtij promovimi, Myftinia Shkodër shtoi edhe një iftar për të pranishmit.

MYFTIU LIGJËROI PARA STUDENTËVE TË AIITC



të shprehura në tre hadithe të profetit Muhammed (a.s). Së pari, atij që agjëron Ramazanin me besim dhe shpresë te Zoti, i falen gjithë gjynahet e së shkuarës. Së dyti, atij që falet gjatë netëve të Ramazanit, i falen gjynahet e së shkuarës. Së treti, ai që kalon me adhurime natën e Kadrit, i falen të gjitha gjynahet. Janë pikërisht këto shtylla, në bazë të të cilave Allahu vërteton devotshmërinë tonë ndaj Tij.

Nëpërmjet Islamit, theksoi ai, njeriu realizon edhe një nga synimet e krijimit të tij, të bëhet mëkëmbës i Zotit në Tokë. Ai

shtoi se besimtarët myslimanë kanë arritur të ruajnë dhe të krijojnë ura komunikimi në të gjithë botën, sepse Kurani është libri që i plotëson dhe përmbush të gjitha shpalljet e mëparshme hyjnore.

Më pas, me ardhjen e kohës së iftarit, ai i ftoi studentët dhe të pranishmit që të çelin iftarin, me urimin që i Lartmadhërisht t'ua ketë pranuar agjërimin dhe me këshillën për ta falënderuar Atë për mirësitë që u ka dhënë në këtë jetë.

Tiranë, 7 qershor 2018

(www.aiitc.net)

Në kuadër të ciklit të hytbeve të Ramazanit 1439 që Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Muhamed B. Sytari po mban në xhaminë e “Dy Vajzave”, të xhuanë e fundit për këtë Ramazan, më 8 qershor 2018, u përqendrua tek vlera e Natës së Kadrit dhe madhësisë së Kur’anit Famëlartë.

Myftiu theksoi se Kur’ani nuk ka zbritur për të zbuluar me xhaminë e tij dhe librotekat me botimet e tij të larmishme, porse ai është udhëzimi i drejtpërdrejtë për racën njerëzore, për ta nxjerrë nga errësira në ditë.

Ai iu referua ajeteve të suresë Natës së Kadrit, ku hodhi ditë mbi shpjegimin e saj, si dhe nxiti shtimin e adhuri eve dhe lutjeve në pjesën e mbetur nga Ramazani i sivjetshëm.

“Në tefsirin e tij, Imam Kurtubiu shpjegon se Nata e Kadrit është nata e madhe e vendimeve, nata e përcaktimeve, “sepse All-llahu i Madhëruar përcakton në të, atë që dëshiron për çdo gjë, deri në vitin e ardhshëm; qoftë vdekje, rizik, etj... Transmetohet nga Ibn Abbasi (r.a.) që thoshte: “Shkruhet atë Natë nga Libri

MYFTIU: “BESNIKËRIA NDAJ RAMAZANIT NIS PAS FITËR BAJRAMIT!”



i Zanafillës, çdo gjë që do të ndodhë gjatë vitit vijues prej rizikut, shiut, jetës e vdekjes, deri haxhilerët!”.

Ndërsa Ikrime e plotëson e thotë: “Do të shkruhen emrat e haxhilerëve të Shtëpisë së All-llahut të Madhëruar në Natën e Kadrit, me emrat e tyre dhe emrat e baballarëve të tyre, nuk pakësohet as shtohet asnjë prej tyre!”...”, shpjegoi ndër të tjera.

Gjithashtu, Myftiu u lut për pranimin e këtij Muajit dhe rimëkëmbjen e ymetit islam në mbarë botën, si një sihariq i madh për të ardhmen e njerëzimit.

Duke përmendur atmosferën dhe shpirtin e besimit, që gjallëron në Ramazan, Myftiu tha se besnikëria e vërtetë ndaj Muajit Ramazan, dëshmohej më së miri me fillimin e Fitër Bajramit.

U FAL TERAVIA E PARË NË XHAMINË E RE TE URA E BUNËS



Ai falënderoi kontributin e madh të z. Gani Kryeziu për realizimin e këtij objekti të ri me vlerë, që natyrshëm do t’i shërbejë komunitetit si një qendër edukimi me frymën e moralit islam dhe

ruajtjes së besimit të zemrave.

Myftiu kërkoi nga fëmijët dhe të rinjtë e pranishëm që ta dinjë se janë muslimanë dhe ta ruajnë fenë e tyre me zemër e ta dëshmojnë me vepra e sjellje.

Më pas, nën drejtimin e teologut Lavdrim Hamja, u krye namazi i teravisë dhe u këmbyen lutje dhe urime me rastin e kësaj nate të shënuar.

Xhamia e re te Ura e Bunës është thaujse e përfunduar dhe me plotësimin e punimeve, do të zhvillohet edhe ceremonia e inaugurimit të saj.

PROGRAMI I NATËS SË KADRIT (DITËN E DIELË, MË 10.6.2018)

Myftinia Shkodër ju fton të bëheni pjesë e programit të adhurimeve dhe lutjeve të Natës së Kadrit të sivjetshme, sipas këtij lajmërimi:

1. Dua e Hatmes së Ramazanit 1439.

Në përfundim të leximit të plotë të Kur’anit Famëlartë, Hatmes Sherife, që u zhvillua gjatë gjithë ditëve të Muajit

Ramazani, ditën e diel, më 10 qershor 2018, pas namazit të iqindisë në xhaminë e Parrucës do të bëhet edhe plotësimi i sureve të fundit të xhyzit të 30-të dhe dua e Hatmes Sherife.

2. Falja e namazit të jaciisë me xhematë në xhaminë e Parrucës.

3. Ligjëratat e rastit nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari.

4. Falja e namazit të teravisë, shoqëruar me pushime të vogla, dhikre dhe salavate.

5. Pas një pushimi të vogël, pas përfundimit të namazit të teravisë, nis mexhlisi i dhikrit dhe dua e xhematë.

6. Namazi i tesbihëve.

7. Adhurime dhe lutje individuale deri në kohën e namazit të sabahut.

All-llahu jua pranoftë adhurimet dhe lutjet tuaja!

MYFTIU: “NATA E KADRIT, KTHESË PËR TË JETUAR ÇDO DITË ME ZOTIN!”



Nga xhamia e Trushit, ku ishte për të falur teravinë e së shtunës, më 9 qershor 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, këshilloi besimtarët që ta shfrytëzojnë kohën e mbetur të këtij Muajit të begatë për të shtuar adhurimet dhe lutjet, në prag të Natës së Kadrit.

Ai theksoi se Nata e Kadrit është një bekim i madh nga All-llahu i Madhëruar, si dhe një moment kthese për çdo musliman, për të jetuar çdo ditë me Zotin.

“Muaji i Ramazanit është një dhunti hyjnore për ymetin e Hz. Muhamedit (a.s), si për të na kujtuar se All-llahu na do çdo ditë si në Ramazan.

Nata e Kadrit në vetvete është një moment kthese, si për të na thënë Zoti nëpërmjet saj se, çdo ditë e jetuar me besim dhe shpresë, me shpirtin e bamirësisë dhe përkushtimin ndaj adhurimit, është ditë dhe natë e shtrenjtë, që peshon rëndë në peshoren e veprave të mira në jetën e

përtejme!”, tha ndër të tjera.

Myftiu i kujtoi xhematit të pranishëm se, të gjithë agjëruesit do të shpërblehen në mënyrë të veçantë në jetën e përtejme,

duke u nderuar me xhennetin, përtej derës mbi të culën shkruhet: “Rejjan”; vendi ku do të shpërblehen për privimin nga uria dhe etja, epihet dhe dëshirat personale, për shkak të agjërimit.

NATA E KADRIT, RINIA TEJMBUSH XHAMITË E SHKODRËS



Nata e Kadrit është e 27-ta e Muajit Ramazan. Ajo pason ditën e njëzet e shtatë një sure që mban emrin e kësaj Nate. Quhet sureja e “Kadrit” dhe bën fjalë për mrekullinë dhe madhësinë e saj.

Si çdo vit, edhe këtë Ramazan, Myftinia Shkodër organizoi të dielën, më 10 qershor 2018 në program të larmishëm që nisi që me namazin e iqindisë, ku u mbyll edhe leximi i plotë i Kur’anit Famëlartë dhe dua e hatmes nga Myftiu i Shkodrës.

Më pas, nga namazi i jaciisë dhe deri në orët e para të mëngjesit pasues, në të gjitha xhamitë e Shkodrës u zhvilluan lutje dhe adhurime të ndryshme, në kërkim të mirësive të kësaj Nate.

Në xhaminë e Parrucës, që ishte tejmbushur nga besimtarët, deri jashtë oborrit, pas faljes së jaciisë u mbajt dersi i kësaj nate nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari.

Pas namazit të jaciisë, u fal edhe namazi i tespihëve me xhematë, për qëllim mësimin dhe kultivimin e tij, si një adhurim me vlerë të veçanta dhe me një shpërblim të madh.

Pas dhikre me xhematë u bë edhe dua e gjuhën shqipe, ku besimtarët u lutën për ymetin islam, për rimëkëmbjen e madhe dhe forcimin e muslimanëve në mbarë botën, për ndriçimin e botës me përhapjen e pandalshme të Islamit, si feja e shekullit 21 dhe shpresa e pashuar e rikthimit të paqes, drejtësisë, moralit dhe mirëqenies në mbarë botën.



Mbrëmjen e së martës, më 12 qershor 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari e fali namazin e teravisë me besimtarët e xhamisë në Krye-Bushat.

Me këtë rast, Myftiu mbajti edhe një këshillë fetare, ku theksoi se, sihariqi më i madh në jetën e muslimanit është garancia e jetës së përtejme! Ai iu referua haditheve që nxisin rritëritjen e besimit me shprehjen: “La ilahe il-lall-llah”, ku theksoi se kjo dëshmi, kur del nga zemra dhe me të vërtetat që bart, e ndriçon të zotin në këtë botë dhe në jetën e përtejme.

Myftiu uroi gjithashtu besimtarët e pranishëm për agjërimin dhe bamirësitë e Ramazanit dhe tha se sihariqi më i madh për agjëruessit është fitimi i pëlqimit të All-llahut dhe xhenneti i garantuar!

MYFTIU: “SIHARIQI MË I MADH PËR AGJËRUESIT ËSHTË XHENNETI NË TË PËRTEJMEN!”



Me rastin e kësaj vizite në xhaminë e re dhe të bukur të Krye-Bushatit, Myftiu

dhuroi edhe një sasi nga libri i tij i ri: “300 HADITHE”.

Ditën e mërkurë, më 13 qershor 2018, Myftinia Shkodër në bashkëpunim me Shoqatën “Ardhmëria”, organizuan një konkurs të mësimit përmendësh të Kur’anit Famëlartë.

Në këtë konkurs morën pjesë një grup i përzgjedhur i nxënësve të kurseve fetare të Myftinisë Shkodër.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin imamë të xhamive pjesëmarrëse, përfaqësues të Myftinisë dhe shoqatës “Ardhmëria”, të cilët ndoqën me kënaqësi konkurrimin e fëmijëve në tre nivele të mësimit përmendësh të Kur’anit Famëlartë.

Në përfundim, aktiviteti u përshëndet edhe nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari dhe Drejtori i Fondacionit “Mirësia”, z. Korab Kaja,

KONKURSI I KUR’ANIT, SI NJË VEÇORI E MUAJIT RAMAZAN



që uruan pjesëmarrësit dhe falënderuan përkushtimin e tyre.

Për fituesit e vendeve të para u

shpërndanë dhurata simbolike, stimulu materialë dhe dëshmia përkatëse e fituesit në këtë konkurs me vlerë.

Mbrëmjen e së mërkurës, më 13 qershor 2018, me rastin e teravisë së fundit të Ramazanit 1439, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari zgjodhi xhaminë e fshatit Barbullush, e njohur ndryshe edhe si xhamia e Iskenderunit.

Me këtë rast, Myftiu uroi besimtarët për agjërimin e Ramazanit të sivjetshëm, sidomos djemtë e rinj dhe vajzat e reja, që këtë Muaj dëshmuar një përkushtim të madh ndaj fesë dhe besimit të tyre.

Myftiu përmendi edhe mirësinë e madhe të realizimit të kësaj xhamie, katër vite më parë, falë binjakëzimit të Myftinisë Shkodër me Myftininë e Iskenderunit në Turqi.

Ndër të tjera, Myftiu u lut që All-llahu i Madhëruar ta begatojë popullin turk, t’i japë mbarësi dhe suksese drejt arritjes së qëllimeve fisnike që gëzojnë mbarë ymetin islam!

Ai tha se sukseset e Turqisë janë

MYFTIU: “MUSLIMANËT E KANË PËR DETYRË TË LUTEN DHE TË PUNOJNË PËR SUKSESET E NJËRI-TJETRIT!”



shpresë për mbarë botën islame dhe se muslimanët e kanë për detyrë të lutën dhe të punojnë për sukseset e njëri-tjetrit!

Gjatë fjalës së tij, Myftiu uroi besimtarët me rastin e Fitër Bajramit

dhe kërkoi që shpirti i përkushtimit dhe forcimit të vëllazërisë islame, bashkëpunimit dhe harmonisë në mesin e muslimanëve të forcohet edhe më shumë në gjurmët e Muajit Ramazan.

FITËR BAJRAMI, SIMBOL BASHKIMI PËR MUSLIMANËT E SHKODRËS

Që në orët e para të mëngjesit të ditës së xhuma, më 15 qershor 2018, rrugët e qytetit të Shkodrës nisën të gjallërojnë nga besimtarë të shumtë, që u drejtuan për në xhamitë e tyre për të dëshmuar bashkarisht lutjet dhe adhurimet e Fitër Bajramit.

Ceremonia kryesore u zhvillua në xhaminë “Ebu Bekër”, ku pas faljes së namazit të sabahut, ligjëratat e parë u mbajt nga imami i kësaj xhamie, teologu Idmir Plaku.

Në fjalën e tij, imami i nderuar dha udhëzime dhe këshilla që lidhen me vlerën e sadekatul-fitrit dhe qëllimet e shpërndarjes së saj. Ai tha se vlera e kësaj lëmoshe qëndron edhe në faktin se ajo e shërben edhe si shlyerje e gabimeve të ndryshme a lëshimeve që mund të ketë bërë agjëruessit gjatë muajit të Ramazanit. Ai e krahasoi sadekatul-fitrin me sehvi-sexhden, që bëhet në fund të namazit, në rastë gabimesh a harresash.

Njëkohësisht theksoi se shpërndarja e kësaj vlerë monetare shërben edhe si mënyrë për të shëruar varfërinë në shoqëritë tona, sepse ajo vjen edhe si ndihmë për të varfrit për të kapërcyer pragun e varfërisë në prag të Festës.

Më pas, fjalën e mori Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i



cili dha edhe mesazhin e tij të kësaj dite, pasi uroi të pranishmit me rastin e Fitër Bajramit.

Ndër të tjera, tha: “Ejani pra, ta dëshmojmë me sa të kemi mundësi këtë Islam në realitetet tona, ta përhapim me sa të kemi mundësi, të ftojme shoqërinë tonë drejt fesë së All-llahut dhe Kur’anit të Tij, ta dëshmojmë bukurinë e kësaj feje dhe ëmbëlsinë e saj, ta mbajmë lart frymën e besimit dhe përkushtimin e Ramazanit, për të mos toleruar shkeljen e shenjtërive tona, për të mos bërë kompromis mbi kurrizin e fesë, për të mos pranuar asnjë shkelje të të drejtave legjitime të besimit dhe vullnetit për ta ndërtuar jetën mbi këtë bekim të madh shekullor!”

Gjatë fjalës së tij, Myftiu u ndal edhe tek përhapja e fenomeneve negative, ku bëri thirrje për respektimin e prindërve, distancimin nga abortet dhe vrasja e foshnjave të posalindura, largimi nga alkooli dhe padrejtësitë, etj.

Një këshillë me vlerë dha edhe teologu Arben Halluni, i cili dha edhe shpjegimet e duhura për mënyrën e faljes së namazit të Fitër Bajramit, që u drejtua nga Myftiu i Shkodrës.

Në shoqërinë e tekbireve, imami i xhamisë, teologu Idmir Plaku mbajti hytben e rastit, me përfundimin e së cilës besimtarët u përshëndetën në mes vete duke uruar begati dhe harmoni me rastin e Fitër Bajramit.

MIQ DHE VIZITORË TË SHUMTË UROJNË FESTËN E FITËR BAJRAMIT

Ditën e parë të Fitër Bajramit, më 15 qershor 2018, pas kryerjes së ceremonisë dhe faljes së Fitër Bajramit në xhamitë e qytetit, Myftinia Shkodër organizoi pritjen tradicionale të miqve dhe vizitorëve, me rastin e kësaj dite të madhe për mbarë besimtarët myslimanë.

Imamët dhe këshilltarët e pranishëm të Myftinisë Shkodër, kanë pritur me këtë rast në ambientet e xhamisë së Parrucës miqtë dhe vizitorët e shumtë, duke nisur nga drejtuesit më të lartë të institucioneve fetare të Shkodrës, drejtuesit e institucioneve vendore e lokale, deputetët, intelektualët dhe besimtarët e shumtë.

Miqtë dhe vizitorët e shumtë shprehën urimet e ngrohta dhe lutjet e tyre, që Zoti t’ua pranojë agjërimin dhe adhurimet gjithë besimtarëve, e t’i japë mirësi e begati Shkodrës dhe mbarë Shqipërisë.

Kjo pritje tradicionale me rastin e



festave fetare dhe respektimi i tyre, nxjerr në pah vlerën e harmonisë dhe bashkëjetesës fetare, si një gjurmë e traditës së respektimit të fesë së tjetrit, veçanërisht në këto ditë, kur mbarë bota

islame gëzon dhe feston ditën e madhe të Fitër Bajramit.

Myftinia Shkodër falënderon të gjithë miqtë dhe vizitorët për urimet dhe lutjet e tyre të përzemërta.

Libra të rinj



300 hadithe, të përzgjedhura, të përkthyer dhe të përshtatura nga arabishtja në gjuhën shqipe nga Imam Muhamed Sytari.

Këto hadithe të vyera janë pjesë e enciklopedisë së mirënjohur të hadithit "El-Xhamius-Sagir", vepër me vlerë e Imam Xhelaluddin ibn Ebi Bekr Es-Sujuti (849-911 h.).

"E Vërteta e Hidhur -2-" nga Shejkh Muhamed El-Gazali, është vijim i kolanës së tij në gjuhën arabe me të njëjtin titull.

Përmes tij autori i bën një mbrojtje dinjitoze Islamit nga dy grupe njerëzish: njëri grup janë myslimanë me dije të cekët, të cilët e njollosin Islamin me diçka që ai nuk e ka, ndërsa grupi tjetër janë armiq të Islamit, që përpiqen ta përbaltin atë me etiketime që nuk i përkasin.



Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org